



LAJME

VIDEO

SPORT

POP NEWS

PROGRAME

YOUTUBE

TOP NEWS LIVE

VOTO ONLINE



AKTUALITET TË FUNDIT

Qarkullonin në Shkodër me pistoletë dhe lëndë narkotike, në pranga dy të rinj

14/12/2023 11:50



Dy të rinj kanë rënë në pranga në Shkodër, pasi qarkullonin në qytet me pistoletë dhe lëndë narkotike, në automjet.

Shërbimet e Patrullës së Përgjithshme të Komisarariatit të Policisë Shkodër, në rrugën “Ethem Osmani”, kanë ndaluar për kontroll automjetin tip “Audi” me të cilin qarkullonin R. V. 18 vjeç dhe N. K, 23 vjeç.

Gjatë kontrollit në automjet dhe kontrollit fizik ndaj tyre, shërbimet e Policisë kanë gjetur pistoletën që dyshohet se e posedonte 18-vjeçari dhe një sasi lënde të dyshuar narkotike kanabis që dyshohet se e posedonte 23-vjeçari.

Arma e zjarrit pistoletë dhe lënda narkotike u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin në pronësi të N. K. dhe 2 celularë.

“Si rezultat i kontroleve të pandërprera të ushtruara në zbatim të planeve operacionale “Sundimi i ligjit” dhe “Tempulli”, bazuar dhe në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, nga strukturat e DVP Shkodër është goditur një rast në fushën e armëmbajtjes pa leje dhe një rast në fushën e narkotikëve”, thuhet në njoftimin e policisë.

Në përfundim të veprimeve të para hetimore , specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër arrestuan në flagrancë dy të rinjtë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.

Top Channel

Aktualitet »



Gjyqi për Gërdecin/ Aldo Bumçi: Me Shkëlzen Berishën jam takuar vetëm për çështje elektorale, nuk i kam nisur kurrë ‘fax’

14/12 13:50



Trafikonin kanabis drejt Turqisë, 7 të arrestuarit mbërrijnë në Gjykatën e Vlorës

14/12 13:29



Arrestohet në Spanjë Lulzim Berisha, pritet ekstradimi drejt Shqipërisë

14/12 12:39



Gjyqi për Gërdecin, Fatmir Mediu: Nuk kam bërë as më shumë as më pak, veçse detyrën time

14/12 12:36



Të dehur në timon e pa leje drejtimi, arrestohen 15 shoferë në dy javë në Elbasan

14/12 12:34



Gjyqi për Gërdecin/ Dëshmon ish-ministri Bumçi, Shkëlzen Berisha nuk paraqitet

14/12 12:20

Na ndiqni:



Top Channel



@topchannelalbania



@tchbreakingnews



Top Channel

Video »



Top Channel/ Trafikonin kanabis drejt Turqisë, 7 të arrestuarit mbërrijnë në Gjykatën e Vlorës



Top Channel/ Qarkullonin në Shkodër me pistoletë dhe lëndë narkotike, në pranga dy të rinj



Top News/ Vranë me thika bashkëmoshatarin, katër të miturit rrezikojnë deri në 8 vite burg



Top Channel/ Të dehur në timon e pa leje drejtimi, arrestohen 15 shoferë në dy javë në Elbasan



Top News/ Të shtëna me armë në Tiranë. Qëllohet drejt një 42-vjeçari, policia identifikon autorin



Top News/ Gjashtë orë sulme me dronë / Rusia godet jugun e Ukrainës, viktima e të lënduar



Kryesore



Athina nuk mbështet integrimin e Shqipërisë/ Rama: Çështja i takon dy vendeve, nuk mund të lidhet me procesin e negociatave!

12:48

Arrestohet në Spanjë Lulzim Berisha, pritet ekstradimi drejt Shqipërisë

12:39

Video/ Qëlloi në drejtim të Rudolf Zefit, zbulohet autori i dyshuar! Lëvizte i qetë para atentatit

11:51

Gjyqi për Gërdecin, Fatmir Mediu: Nuk kam bërë as më shumë as më pak, veçse detyrën time

12:36

Sprova e fundit e Ballkanit! Sot kërkon kualifikimin në Conference League përballë Dinamos së Zagrebit

12:21

Më të lexuarat

Mitsotakis takon Ramën në Bruksel: Athina nuk do të mbështesë integrimin e Shqipërisë pa u zgjidhur çështja e Belerit

Përfundon samiti BE-Ballkani Perëndimor/ Michel: Integrim gradual të vendeve në bllok

Dudushi ngre tonet ndaj zëdhënësit të Belerit: Çfarë pune ka Greqia, që fut hundët në Himarë?

Zbuloni parapaskenat nga xhirimet e këngës së fundvitit të Top Medias

Konfiskohen pronat e Redjan Rrajës/ I dënuar me burgim të përjetshëm me akuzën e vrasjes

Fotolajm/ Pasojat e sulmit me dron në Odesa

Video/ Qëlloi në drejtim të Rudolf Zefit, zbulohet autori i dyshuar! Lëvizte i qetë para atentatit

Arrestohet në Spanjë Lulzim Berisha, pritet ekstradimi drejt Shqipërisë

Tre veprime që nuk duhet t’i bësh pasi ke ngrënë

Gjendet një trup i pajetë në lumin Lana

Lajme

Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Futboll
Kombëtarja
Formula 1
Tregu i Futbollit

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

VOTO ONLINE
Dancing with the stars
Për’puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use